

INTEGRITETI



INTEGRITET DHE ETIKË

SEMPER VIGILE

> IPK.RKS-GOV.NET



Lufta kundër korrupsionit Operacioni “Pika 1” dhe “Pika 2”

Drejtues të IPK-së dhe AMP-së
takuan Zëvendës ndihmës
sekretaren e Departamentit
Shtetit të SHBA-ve



INTEGRITETI



INTEGRITET DHE ETIKË

SEMPER VIGILE

> IPK.RKS-GOV.NET



Lufta kundër korrupsionit Operacioni “Pika 1” dhe “Pika 2”

info

zimp.ipk@rks-gov.net

Revista “Integriteti” është botim i Inspektoratit Policor të Kosovës

Divizioni për Marrëdhënie me Publikun dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar

Botues: Inspektorati Policor i Kosovës

Kryeredaktor:
Arbër BEKA

Ndihmës Redaktor:
Arben Vrajolli
Albinë Ejupi

Tel: +383 (0) 44 146 696
E-mail: arber.beka@rks-gov.net,
arberbeka@gmail.com, zimp.ipk@rks-gov.net

INTEGRITETI



Ligji për pensionimin e parakohshëm – afër dhe larg.....	4
Këndi i ICITAP-it – 2022 në rishikim.....	6
Lufta kundër korrupsionit – Operacioni Pika 1 dhe Pika 2.....	8
Vazhdon përkrahja e SHBA-vë për agjencitë e zbatimit të ligjit.....	11
Kamerat trupore të policisë – nga një këndvështrim tjetër.....	12
IPK pranoi nga Misioni i OSBE-së donacion 33 libra.....	15
Organizatat jo-funksionale dhe lidhshipi transformues.....	16
Rëndësia e integritetit të zyrtarët e zbatimit të ligjit.....	19
IPK publikoi dy raporte të inspektimit	20
IPK pjesë e konferencës profesionale të NIAIA.....	22
Foto lajme.....	23

PËRMBAJTJA



PIKË SHITESË:

Mendimet, komentet, këndvështrimet e shprehura ose të përfshira në përmbajtje të këtij botimi nuk paraqesin medeomos politikat ose vështrimet zyrtare të IPK-së.

Ligji për pensionimin e parakohshëm

Ka vite me radhë (së paku shtatë vite) prej se grupet e para punuese kanë qenë të angazhuara për draftimin e projekt-ligjit për pensionimin e parakohshëm të zyrtarëve policorë dhe punonjësve të IPK-së me autorizime policore.

Të dhënat për moshën mesatare të punonjësve janë nxjerrë vazhdimisht nga burimet njerëzore si të IPK-së ashtu edhe të PK-së si pjesë e analizave të nevojshme për draftimin e këtij ligji.

Por si është situata në ditët e sotshme lidhur me moshën mesatare por edhe sfidave të tjera që ballafaqohet IPK-ja dhe Policia e Kosovës?

Momentalisht moshja mesatare e zyrtarëve policor ka arritur në mbi 47 vjet dhe nuk kanë munguar as kërkesat për miratimin e projekt-ligjit për pensionim të parakohshëm nga deputetë, shoqëria civile dhe vet policia:

“Policia e Kosovës për nga themelimi është ndër policitë më të reja në rajon dhe më gjerë, por për nga moshja e zyrtarëve të saj pothuajse se është ndër më të vjetrat. Ashtu siç e kemi theksuar edhe më herët, moshja mesatare e personelit policor ka arritur në 47-vjet dhe vazhdon të rritet si e tillë, ku me këtë moshë është shumë problem realizimi i misionit dhe vizionit policor si dhe arritja e rezultateve pozitive”, thuhet në një letër të sindikatës drejtuar Ministrit të Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla dhe e cila është bërë publike edhe në medie.

Situatë e ngjashme është edhe në Inspektoratin Policor të Kosovës. Pavarësisht se si mekanizëm mbikëqyrës për punën e policisë është themeluar 7 vite më vonë (në vitin 2006), moshja mesatare e punonjësve operativ në IPK është rreth 45 vjet.

Nëse miratohet ky projekt ligj në të ardhmen e afërt, për IPK-në sfiduese do të ishte krijimi i dy skemave pensionale për punonjësit e saj

operativ. Kjo pasi që versioni aktual i projekt ligjit për pensionim përjashton zyrtarët e departamentit të inspektimeve të cilët bazuar në bazën ligjore aktuale në fuqi (ligji për Inspektoratin Policor të Kosovës) nuk kanë autorizime policore.

Mbetet të shihet nëse kjo sfidë mund të adresohet gjatë procesit të plotësimit ndryshimit të ligjit për IPK-në duke vendosur në një kategori të gjithë punonjësit operativ (hetuesit dhe inspektorët si kategori e njëjtë – inspektorët policorë apo ndonjë emërtim tjetër).

Edhe ashtu që nga procesi i rekrutimit, trajnimit bazik e ai fushor, zyrtarët e IPK-së nga pjesa operative nuk dallojnë nga njëri tjetri (hetuesit dhe inspektorët).

Përndryshe ligji pritet të rregulloj dhe përcaktoj kushtet dhe kriteret për garantimin e pensioneve, llojet e pensioneve, si dhe përcakton kategorizimin e pensioneve për pension për zyrtarët policor të Policisë së Kosovës dhe punonjësit e Inspektoratit Policor të Kosovës me autorizime policore dhe familjarët e tyre.

Me të njëjtin pritet të parashihen këto lloje të pensioneve (bazuar në draftin e fundit): pensionin e rregullt, pensionin invalidor, pensionin familjar dhe pensionin vullnetar.

Sipas versionit të fundit , zyrtari policor/punonjësi i Inspektoratit Policor të Kosovës me autorizime policore fiton të drejtën në pension të rregullt, nëse moshja e tij arrin në pesëdhjetë e pesë (55) vjet.

afër dhe larg

Baza e pensionit të rregullt të punonjësit të Inspektoratit Policor të Kosovës me autorizime policore sipas draftit të fundit të projektligjit, nga niveli zbatues deri në nivelin e lartë menaxherial është dyzet 40% e pagës bruto në kohën pensionimit. Për çdo vit shërbimi si punonjës i Inspektoratit Policor të Kosovës me autorizime policore koeficienti i përqindjes rritet për 2%, por nuk mund të kalojë gjashtëdhjetë 60% e pagës bruto.

Sipas projektligjit, zyrtari policor/punonjësi i Inspektoratit Policor të Kosovës me autorizime policore mund të pensionohet vullnetarisht prej moshës pesëdhjetë (50) vjeçare, i cili ka së paku pesëmbëdhjetë (15) vite shërbim efektiv në Polici/IPK, me pagesë të pensionit prej tridhjetë e pesë 35% të pagës bruto.

Tutje në projekt ligj ceket se zyrtarit policor/punonjësit të Inspektoratit Policor të Kosovës me autorizime policore koeficienti i përqindjes së pensionit do t'i rritet për një 1%, për çdo vit përvojë pune, por jo më shumë se pesëdhjetë 50% e pagës bruto.

Lartësia e pensionit të rregullt të zyrtarit policor/punonjësit të Inspektoratit Policor të Kosovës me autorizime policore llogaritet në bazë të përqindjes së pagës bruto të zyrtarit dhe kohës së shërbimit. Paga bazohet në gradën e zyrtarit policor në Policinë e Kosovës ndërsa në bazë të nivelit udhëheqës në Inspektoratin Policor të Kosovës, në momentin e pensionimit. Derisa grupet punuese angazhohen kohë pas kohe lidhur me këtë projekt ligj, si IPK ashtu edhe PK po vazhdojnë të ballafaqohen me sfidat e moshës mesatare e që shpesh paraqet sfidë në aspektin operativ.

Në bazë të informacioneve të fundit që janë bërë publike nga vet MPB-ja lidhur me këtë projekt ligj është se ai është duke u shqyrtuar në Ministrinë e Financave dhe mbetet të shihet nëse i njëjti do të procedohet këtë vit në Kuvendin e Republikës së Kosovës apo vitin e ardhshëm.

Nga : **Arbër Beka**

Divizioni për bashkëpunim dhe informim





Këndi i ICITAP-it - 2022 në rishikim

Përshëndetje nga ekipi juaj ICITAP,

Ky vit ka ofruar shumë arritje të jashtëzakonshme në kuadër të Inspektoratit Policor, së bashku me sfidat e renovimeve të mëdha në objekt. Përmes masave inovative dhe përdorimit të laptopëve misioni i IPK-së vazhdoi pa ndërprerje.

Qëndrueshmëria e zyrtarëve të IPK-së ka qenë e dukshme në storiet e vazhdueshme të suksesit dhe veprimet e të gjithë punonjësve. Operacioni Pika në pikat kufitare, edhe një herë u mundësoi qytetarëve të Kosovës një pamje transparente të punës së vazhdueshme të IPK-së në luftimin e korrupsionit nga zyrtarët policorë.

Ekipi juaj i ICITAP-it ka shërbyer së bashku me agjencinë duke parë që shumë ngjarje të zhvillimit të kapaciteteve të zhvillohen. Ne presim një partneritet produktiv dhe fuqizues ndërsa kalojmë në vitin 2023. Mbështetja jonë e vazhdueshme nga Departamenti i Drejtësisë, Ambasada e SHBA-së në Prishtinë dhe Byroja e Çështjeve Ndërkombëtare të Narkotikëve dhe Zbatimit të Ligjit (INL) na ofron një platformë për sukses në këtë mision.

Dera e zyrës së ICITAP-it është gjithmonë e hapur për sugjerime dhe biseda për përmirësimin e ekipit, ndaj ju lutemi ndaloni ndërsa ne vazhdojmë të rritemi si një ekip.

Ne kemi dashur të shfrytëzojmë këtë rast për të ndarë disa nga rezultatet e punës sonë, në partneritet me IPK-në në vitin 2022:

- Mentorimi dhe këshillimi i Kryeshefit, drejtorëve dhe stafit në baza ditore.
- Rishikimi i nevojave të IPK-së për trajnim dhe pajisje për vitin 2022 të dorëzuar nga stafi komandues.
- Dorëzimi i planit të punës së propozuar 2022-2023 për partneritetin ICITAP-IPK.
- Pjesëmarrja në punëtori për Planin Strategjik 3-vjeçar të IPK-së.
- Udhëtim studimor me bazë në SHBA në Zyrën e Policisë Shtetërore të Njësisë të Standardeve Profesionale të Uashington DC dhe Virxhinia.
- Zhvillimi dhe zbatimi i një mjeti raportimi specifik për agjencinë CompStat.

- Trajnim me dron për zyrtarët e IPK-së.
- Sigurimi i politikave të praktikave më të mira për; Uniformat dhe pajisjet, Njoftimi për incidentin, planet operative, mediat sociale, përdorimi i pajisjeve të urgjencës, hetimet e sfondit dhe kërkesat për transferim të brendshëm.
- Lehtësimi i vlerësimit të Byrosë Ndërkombëtare të Narkotikëve dhe Çështjeve të Zbatimit të Ligjit (INL) të IPK-së.
- Pjesëmarrje në prezantimin e IPK-së me temën "Roli dhe rëndësia e integritetit në zyrtarët e agjencive të sigurisë" në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike.
- Pjesëmarrja në informimet e agjencive para ngjarjeve për operacionin "Pika 1 dhe 2".
- Paraqitja e kandidatëve të IPK-së për Programet e Liderimit të Vizitorëve Ndërkombëtarë për vitin 2022 dhe 2023.
- Koordinimi i prezantimit të "Pikës së Operacionit 1&2" tek Zëvendës Ndihmës Sekretarja e INL-it znj. Johnson.
- Rekomandimi i Kryeshefit Ekzekutiv të IPK-së për shqyrtim në Çmimin Ndërkombëtar të Kampionëve Anti-Korrupsion të Sekretarit të Shtetit të Shteteve të Bashkuara për vitin 2022.
- Paraqitja e kandidatëve të IPK-së për trajnime të sponsorizuara nga ILEA në Budapest në vitin 2023.
- Pjesëmarrja në Festën e Krenarisë 2022 në Prishtinë.
- Zhvillimi dhe implantimi i një procesi të ri të brendshëm për përzgjedhjen e zyrtarëve për trajnimin e sponsorizuar nga ICITAP, duke përfshirë reklamimin e gjerë të agjencive të trajnimit dhe intervistat e kandidatëve.
- Vëzhgimi në terren nga ekipi i ICITAP-IPK gjatë inspektimeve në objektet e PK-së.
- Pjesëmarrja në ceremonitë përkujtimore të 11 shtatorit në Pejë.

Nga: Shqipe Durguti dhe Michael McKee

IPK shënoi përvjetorin e 16-të të themelimit

Inspektorati Policor i Kosovës mbajti një ceremoni me rastin e shënimit të përvjetorit të 16-të. Në këtë aktivitet, krahas zyrtarëve të IPK-së morën pjesë edhe përfaqësues të lartë të institucioneve vendore dhe ndërkombëtare.

Ceremonia u përcoll edhe me fjalë rasti që përshkruan rrugëtimin 16 vjeçar të IPK-së duke vënë në pah sfidat dhe sukseset e treguara.

Kryeshefi i IPK-së z.Kushtrim Hodaj në fjalën e tij në këtë ceremoni potencoi sukseset duke falënderuar të gjithë zyrtarët e IPK-së për angazhimet e tyre:

“ Në vitin 2006, Republika e Kosovës e ndihmuar nga Misioni i OSBE-së zgjodhi një nga modelet më demokratike të kontrollit dhe mbikëqyrjes ndaj punës së Policisë . Të vetëdijshëm që IPK ka një mision sfidues, ne nuk jemi ndalur duke punuar pareshtur në arritjen e objektivave strategjike dhe operacionale. Në këtë përvjetor ne jemi akoma më të përkushtuar që të vazhdojmë të përmbushim misionin në luftimin e çdo të keqeje që kërcënon dhe rrezikon organizatën policore”- theksoi ndër të tjera z.Hodaj duke falënderuar edhe partnerët ndërkombëtarë si ICITAP, INL dhe OSBE për përkrahjen e dhënë në vazhdimësi për IPK-në.

Për rolin dhe rëndësinë e mandatit të IPK-së dhe sukseset e treguara ndër vite u fol edhe në fjalët e rastit nga Atasheja e ICITAP-it pranë Ambasadës Amerikane në Kosovë znj.Kimberly Riffe, ambasadori i Misionit të OSBE-së në Kosovë z. Michael Davenport dhe ushtruesi i detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit z. Besim Kelmendi.

Inspektorati Policor i Kosovës duke vlerësuar lart kontributin e dhënë nga secili zyrtar i saj por edhe partnerët vendor dhe ndërkombëtar, në këtë ceremoni ndau medalje për zyrtarë të dalluar të IPK-së, zyrtarë të ICITAP-it, INL-it, OSBE-së dhe Prokurorisë së Shtetit.

Me rastin e shënimit të këtij përvjetori, IPK në bashkëpunim me Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut ka organizuar edhe dhurimin vullnetar të gjakut nga punonjësit e IPK-së.



Operacioni “Pika”

Operacioni Pika 1 dhe 2 vë në pranga dhjetëra të dyshuar për keqpërdorim të detyrës zyrtare dhe marrje të ryshfetit



Gjithçka filloi mëngjesin e 14 marsit kur Inspektorati Policor i Kosovës me urdhër të Prokurorisë Speciale filloi së realizuari operacionin e koduar me emrin “Pika” në Gjakovë dhe Prizren.

Operacionit parapriu një hetim rreth një vjeçar me dyshimin për përfshirje në aktivitete të kundërligjshme të një numri të zyrtarëve policorë lidhur me veprat penale “marrje e ryshfetit” dhe “keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”.

Realizimi i operacionit “Pika 1” u përkrah edhe nga Agjencia e Kosovës për Inteligjencë, Dogana e Kosovës dhe Policia e Kosovës.

Inspektorati Policor i Kosovës respektivisht hetuesit e Departamentit të Hetimeve muaj më parë kishin pranuar informacione përmes rrugëve operative lidhur me dyshimet për përfshirjen në aktivitetet të kundërligjshme të disa zyrtarëve policorë të punësuar në Drejtorinë Rajonale kufitare “Perëndimi” në Gjakovë respektivisht pikë kalimeve kufitare

në Qafë Prushë dhe Qafë Morinë si dhe dy zyrtarëve doganorë.

Me autorizimin e Prokurorisë Speciale në kuadër të këtij hetimi nga hetuesit e IPK-së u përshinë edhe masat e fshehta dhe teknike të vëzhgimit dhe hetimit si dhe masat e nevojshme që të zbulojnë dhe të ruajnë gjurmët dhe provat tjera të veprave penale dhe sendet të cilat mund të shërbejnë si prova të cilat mund të përdoren në procedurë penale.

Bazuar në këto veprime IPK në kuadër të operacionit “Pika 1” arrestoi 48 zyrtarë policorë (duke përfshirë dy togerë policorë – komandantë të pikë kalimeve kufitare në Qafë Prush dhe Qafë Morinë dhe pesë rreshterë) si dhe dy zyrtarë doganorë, që të gjithë të dyshuar për veprat penale “keqpërdorim i detyrës apo autoritetit zyrtar” “marrje e ryshfetit”.

Nga realizimi i veprimeve hetimore nga hetuesit e IPK-së ekziston dyshimi se të arrestuarit në këtë rast janë të involvuar me qindra herë (mbi 400 herë) në veprimtari kriminale të veprës penale të “marrjes së ryshfetit” dhe “keqpërdorimit të detyrës apo autoritetit zyrtar”.





Hetimi dhe operacioni nuk përfundoi me kaq. Më 8 prill Inspektorati Policor i Kosovës me urdhër të Prokurorisë Speciale realizoi operacionin e koduar me emrin “Pika 2” në Prizren respektivisht në pikë kalimin kufitar në Vërmicë.

Në kuadër të operacionit “Pika 2” u arrestuan 26 zyrtarë policorë (duke përfshirë dy rreshterë policorë dhe 24 zyrtarë policorë), që të gjithë të dyshuar për veprat penale “keqpërdorim i detyrës apo autoritetit zyrtar” “marrje e ryshfetit”.

Si pjesë e procedurave administrative nga IPK ishte dhënë edhe rekomandimi për suspendim nga detyrat e punës për zyrtarët tashmë të arrestuar.

Hetimi kishte përfshirë edhe bashkëpunimin me SPAK-un (Struktura e Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar e Republikës së Shqipërisë) Agjencinë për Mbikëqyrje Policore - AMP-së (agjencia homologe e IPK-së në Shqipëri) që ka rezultuar me arrestimin e disa të dyshuarve edhe në Republikën e Shqipërisë.

Që të dy operacionet u përcollën me interes të madh nga opinioni publik.

Sindikata e Policisë së Kosovës kishte reaguar

për arrestimet e zyrtarëve . Sipas një komunikate për media, vërejtjet dhe kërkesat e Sindikatës së Policisë kanë qenë që IPK-ja të mos bëjë veprime spektakulare dhe të gjitha veprimet e IPK-së të jenë profesionale dhe arrestimet të bëhen duke siguruar prova të qëndrueshme para veprimeve të tyre.

“Sindikata e Policisë së Kosovës, arrestimet e fundit në pikat kufitare, i konsideron të papranueshme për faktin se, zyrtarët policorë janë trajtuar si kriminelë dhe janë akuzuar për vepra kriminale, pa siguruar prova për veprat e pretenduara nga IPK-ja, këtë që po e themi e vërteton edhe Vendimi me nr.PPS nr. 13/2022, me numër të lëndës 2022:0018374, i lëshuar me datë 02.08.2022 nga Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, për ndërprerjen e hetimeve ndaj tre zyrtarëve policorë të përfshirë në këto arrestime. Ky vendim e konfirmon shqetësimin tonë të shprehur në vazhdimësi se arrestimet e zyrtarëve policorë po bëhen me nguti, pa siguruar prova dhe pa i shterur të gjitha mundësitë e parapara sipas Kodit të Procedurës Penale”, thuhet në njoftimin e Sindikatës së Policisë.



duke u zotuar për të shtuar intensitetin e luftës ndaj fenomenit.

“Besojmë fuqishëm që edhe Policia e Kosovës e ka këtë synim dhe e mbështet IPK-në siç e ka bërë deri tani në këtë mision të rëndësishëm për sundimin e ligjit në Republikën e Kosovës. Duke i falënderuar të gjithë qytetarët për bashkëpunim, IPK beson se fuqizimi i integritetit policor është mision i përbashkët dhe duhet të përkrahet nga të gjithë”, potencohet në komunikatën e IPK-së.

IPK i është përgjigjur Sindikatës duke bërë thirrje publike që aktivitetet që ndërlidhen me fuqizimin e integritetit policor janë mision i përbashkët dhe duhet të përkrahen nga të gjithë:

“Të gjitha veprimet në kuadër të këtij hetimi janë ndërmarrë sipas udhëzimeve dhe në koordinim të plotë të Prokurorisë së Shtetit, duke përfshirë edhe arrestimet e secilit prej tyre. Sigurisht që për këtë rast ka prova dhe të njëjtat janë dorëzuar në Prokurorinë Speciale, ashtu siç e parasheh Kodi i Procedurës Penale.

Sidoqoftë provat nuk mund tua prezantojmë Sindikatës së Policisë. Shumica e veprimeve inkriminuese të zyrtarëve policorë të dyshuar në këtë rast janë të dëshmuara më zë dhe figurë. Është kompetencë e prokurorit të vlerësoj dhe vendos më tutje vazhdimin e procedurave penale për secilin prej të dyshuarve në këtë rast. IPK siç parashihet edhe me Kodin e Procedurës Penale u ka dhënë mundësinë dhe të gjithë të dyshuarit në këtë rast janë mbrojtur dhe mbrohen nga avokatet e tyre sipas procedurës”, thuhet në komunikatën e IPK-së.

Në këtë komunikatë IPK ka shprehur shqetësimin për nivelin e korrupsionit në Polici

Operacionet Pika 1 dhe Pika 2 u vlerësuan lart edhe nga partnerët ndërkombëtar ku në korrik Kryeshefi Ekzekutiv i IPK-së së bashku me Drejtorin e Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore (AMP-së) të Republikës së Shqipërisë priten në takim Zëvendës ndihmës sekretaren e Departamentit Shtetit të SHBA-ve Lisa A. Johnson e cila vlerësoi lart suksesin e IPK-së dhe AMP-së në realizmin me sukses të operacionit Pika 1 dhe 2.



Drejtues të IPK-së dhe AMP-së takuan Zëvendës ndihmës sekretaren e Departamentit Shtetit të SHBA-ve

Vazhdon mbështetja e fuqishme e SHBA-ve për agjencitë e zbatimit të ligjit

Kryeshefi Ekzekutiv i IPK-së së bashku me Drejtorin e Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore (AMP-së) të Republikës së Shqipërisë në fund të muajit korrik pritën në takim Zëvendës ndihmës sekretaren e Departamentit Shtetit të SHBA-ve Lisa A. Johnson dhe përfaqësues nga Sektori për Diplomaci publike.

Takimi u zhvillua në pikën e përbashkët kufitare në Vërmicë ku ndër tjera u prezantua puna e përbashkët në realizmin me sukses të operacionit antikorrupsion “Pika 1 dhe 2”.

Kryeshefi i IPK-së z. Hodaj dhe Drejtori i AMP-së z. Rrumbullaku, falënderuan znj. Johnson për ndihmën e Departamentit të Shtetit përmes INL-t ((Byroja Ndërkombëtare për Lëndë Narkotike dhe Zbatim të Ligjit) dhe ICITAP në fuqizimin e kapaciteteve profesionale të agjencive përkatëse.

Ndihmës sekretarja Johnson vlerësoi lart suksesin e IPK-së dhe AMP-së në realizmin me sukses të operacionit Pika 1 dhe 2 dhe shprehu gatishmërinë e SHBA-ve në mbështetjen edhe me të fuqishme të institucioneve në luftimin e korrupsionit në polici si fenomen që dëmton besimin e qytetarëve në institucione të zbatimit të ligjit.



Kamerat trupore të policisë nga një këndvështrim tjetër

Diskutimet publike që bëhen për vendosjen e kamerave trupore te zyrtarët policorë i japin shpjegim projekteve të tilla si përdorim i teknologjisë në shërbim të transparencës, llogaridhënies, përgjegjshmërisë dhe reformave në polici. Projekte të tilla shihen edhe si përpjekje dhe përkrahje drejt reduktimit të nivelit të kriminalitetit, si diçka që mund të ofrojë dëshmi shtesë në procedurë penale, fuqizon legjitimitetin e policisë dhe si diçka që mund të reduktojë perceptimin negativ të qytetarëve lidhur me abuzimin me fuqinë ligjore që i është dhënë policisë (dyshimet në rastet e tejkalimeve të autorizimeve policore gjatë përdorimit të forcës).

Kohë më parë Policia e Kosovës ka bërë publike disa iniciativa për furnizimin e zyrtarëve policorë me kamera trupore.

Një iniciativë e tillë për herë të fundit u ri-aktualizua edhe nga Ushtruesi i detyrës së Drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Kosovës z.Fehmi Hoti kur priti në takim Tamra Greig, drejtoreshë në Zyrën për Çështje Ndërkombëtare të Narkotikëve dhe Zbatim të Ligjit (INL) dhe znj. Kimberly Riffe atasheun e DOJ-ICITAP, nga Ambasada e SHBA-së. Në njoftimin e Policisë së Kosovës, thuhet se ky takim është i karakterit njoftues me drejtoreshën e re të INL-it por vëri në dukje edhe pilot projektin e kamerave për trup:



“Takimi përveç se ishte i karakterit njoftues me drejtoreshën e re të INL-it dhe në anën tjetër lamtumirës me ish drejtorin e INL-it Shawn Waddoups, u diskutuan tema mjaft të rëndësishme me interes në fushën e sigurisë, përfshirë mbështetjen me trajnime të avancuara dhe me projekte të ndryshme, siç është edhe pilot projekti i sistemit të kamerave për trup, ku pritet që zyrtarët policorë në të ardhmen të pajisen me këto kamera”, - thuhet ndër të tjera në njoftimin e policisë.

Për këtë çështje edhe ne si institucion kemi pranuar pyetje nga medie të ndryshme që kanë shprehur interesimin lidhur me këtë iniciativë dhe qëndrimi zyrtar i IPK-së ka qenë se përkrahin iniciativa të tilla dhe se pajisja e zyrtarëve policorë me kamera trupore mund të ketë efekt preventiv.

Por cilat janë sfidat që janë ballafaquar policitë e vendeve tjera në botë që kanë filluar vite më herët me projekte të tilla (kryesisht prej vitit 2015 e tutje)?

Në shumë organizata policore që kanë përdorur kamerat e trupit në operacione të ndryshme policore kanë ardhur në konkludim se përdorimi i kamerave të tilla redukton numrin e ankesave ndaj zyrtarëve policorë (Sander Flight, faqe 28, How bodycams work).

Por brenga është në atë se në cilat raste ose cilat kushte duhet të plotësohen që zyrtari policor të shtyp butonin 'rec' në kamerë, deri ku shkon diskrecioni i zyrtarëve policor lidhur me këtë çështje, ku ruhen të dhënat (videot) dhe nga kush, cilat video mund të bëhen publike dhe nga kush, si mund dhe a mund të përdoren si dëshmi në gjykatë video-incizimet, kush tjetër mund të ketë qasje në këto video incizime, cilin dizajn ose produkt i kamerave duhet

përzgjedhur, a duhet të ketë paralajmërim për qytetarët se të njëjtit janë duke u incizuar (praktika e Gjermanisë ku zyrtarët policorë që bartin kamera trupore bartin shenja të mëdha para dhe prapa uniformës së tyre për të njoftuar qytetarët për prezencën e kamerës trupore) etj. Më herët në këtë shkrim kemi përmendur edhe dizajnin e kamerave i cili mund të jetë faktor i rëndësishëm lidhur me dukshmërinë e kamerës në uniformë pastaj lloji i kamerës dhe baterisë së saj duke ditur rëndësinë se sa orë e njëjta mund të incizojë (nëse rregullohet me procedurë të brendshme se zyrtari duhet të regjistrojë/incizoj gjatë tërë ndërrimit që zakonisht është tetë orë, sa qëndron bateria e saj!!!).

Nëse Policia e Kosovës planifikon që të fillojë në të ardhmen e afërt me projektin e kamerave të trupit, një komponentë shumë e rëndësishme është se si do ta prezantojë këtë projekt para qytetarëve.

Këtu vjen në shprehje konjeksti social dhe cilat janë pritshmëritë e komunitetit. Në një zonë-rajon ku besueshmëria në polici është e lartë vendosja e kamerave trupore te zyrtarët policorë mund të shihet si një mjet i cili do të ndikojë në përmirësimin dhe fuqizimin e profesionalizimit.

Nëse për rajonin specifik kohëve të fundit ka pasur shkrime të shumta në medie për tejkallimet e autorizimeve policore në rastet e përdorimit të forcës dhe kamera trupore prezantohet si një mjet që mund të ndikojë në rikthimin apo fuqizimin e besueshmërisë, atëherë kjo mund të nxis debate të ndryshme tek shoqëria civile apo mediet por edhe te komuniteti policor.



Kur flasim për zyrtarët policorë dhe pritshmëritë e tyre, për të njëjtit do të jetë shumë e rëndësishme se si do të bëhet prezantimi i rasteve të para pas fillimit të projektit. Nëse rastet e para që mbase do të bëhen publike brenda organizatës policore apo edhe tek qytetarët flasin për këtë projekt si të suksesshëm dhe ndihmues për policinë në luftimin e kriminalitetit dhe dëshmimin e veprave penale, atëherë zyrtarët policorë do ta mbështesin dhe nuk do të kenë hezitime që të përdorin kamerat trupore.

Mirëpo, në anën tjetër, nëse rastet e para që do të bëhen publike qoftë brenda policisë apo edhe në publik kanë të bëjnë me dyshimet për tejkalim të autorizimeve policore gjatë përdorimit të forcës, atëherë zyrtarët do ta shohin projektin me hezitim.

Bazuar në studime të ndryshme (kryesisht në SHBA), si sfida tjetër që duhet pasur parasysh në projekte të tilla, ku përdoren pajisje të teknologjisë është edhe komponenta e trajnimit. Pavarësisht se sa në detaje mund të përgatiten aktet nënligjore lidhur me rrethanat e përdorimit të kamerës trupore (kur lëshohet, kur ndalet, kur fillohet incizimi), nëse të njëjtat nuk përcillen me trajnime konkrete mund të mos sjellin rezultatet e pritura.

Bazuar në këto, i bie që duhet të merret parasysh konteksti policor, social dhe teknologjik kur janë në pyetje projekte të tilla. Sidoqoftë, projekti i tillë nëse realizohet në të ardhmen e afërt, do të sjell mundësi të reja lidhur me reagimet policore duke ofruar vendimmarrësve në polici që të kenë një pasqyrë akoma më të qartë lidhur me nivelin e profesionalizimit e zyrtarëve të tyre, nivelin e

kulturës së organizatës, mund të shihet si një mjet i vogël i teknologjisë që mund të sjell ndryshime të mëdha në organizatë, mund të ndihmojë shumë që të përmirësohet niveli i profesionalizimit gjatë reagimeve policore (duke analizuar psh reagimet policore gjatë një bastisje apo kontrolli të turmave) etj.

Në fund fare do të ofrojë mundësi të shohim reagimet policore nga 'sytë' e një zyrtari policor siç nuk i kemi parë kurrë më parë.

Nga Arbër Beka

Divizioni për bashkëpunim dhe informim
Inspektorati Policor i Kosovës



IPK pranoi nga Misioni i OSBE-së donacion 33 libra që mbulojnë fushën e mbikëqyrjes policore dhe menaxhimit policor

Drejtori i Departamentit për Siguri Publike në Misionin e OSBE-së në Kosovë z. Edward Anderson me bashkëpunëtorë gjatë një takimi me zyrtarë të lartë të IPK-së dhuroi një donacion të vlefshëm për IPK-në.

Në kuadër të këtij takimi zyrtarët e IPK-së pranuan një donacion prej 33 librave profesional nga Misioni i OSBE-së.

Në mungesë të librave profesional në gjuhën shqipe që mbulojnë fushën e mbikëqyrjes policore dhe shkencës së menaxhimit policor, ky donacion i titujve profesional në gjuhën angleze konsiderohet i rëndësishëm për fuqizimin e kapaciteteve profesionale të punonjësve të IPK-së.

Librat që IPK pranoi donacion sot e që do të jenë pjesë e bibliotekës së Inspektoratit trajtojnë tema të mbikëqyrjes policore, fuqizimit të integritetit policor dhe luftimit të korrupsionit, hetimit të rasteve të përdorimit të forcës nga zyrtarët policorë (duke përfshirë edhe forcën vdekjeprurëse), policimit në bashkësi etj.

Furnizimi me këto libra pritet të ketë ndikim pozitiv në ngritjen e nivelit të profesionalizimit të IPK-së duke fituar njohuri të reja për fushat e lartcekura por edhe në aspektin e realizimit të aktiviteteve të natyrës preventive bazuar në qasje shkencore dhe praktikat më të mira ndërkombëtare.

Zyrtarët e Inspektoratit Policor të Kosovës falënderuan për përkrahjen që misioni i OSBE-së është duke dhënë në vazhdimësi për IPK-në në ngritjen e kapaciteteve profesionale.



ORGANIZATAT JO-FUNKSIONALE DHE LIDERSHIPI TRANSFORMUES



Çdo organizate në një kohe të caktuar gjendet përballë ndryshimeve të brendshme dhe të jashtme të cilat sfidojnë atë. Në shekullin në të cilin po jetojmë përparimet teknologjike dhe shkencore janë duke avancuar në mënyrë të paparashikuar duke ndryshuar rregullat shoqërore dhe stilin e jetës të mbarë njerëzimit e me to janë duke ndryshuar edhe njohuritë, praktikat dhe kultura e organizatave në të gjitha organizatat përfshirë edhe ato policore.

Për të dhënë një pasqyrë sa më të mirë të këtyre ndryshimeve, me fokus në ndryshimet në organizatat me autorizime policore gjatë këtij shkrimi do ti referohem autorëve; William.F.Walsh & Genaro.F.VITO (libri Lidershipi Policor dhe Administrata, Qasje

strategjike e Shekullit 21), ku në vijim paraqiten dy koncepte bazë.

Së pari: cilat janë fazat në të cilat kalon një organizate policore apo e zbatimit të ligjit e cila arrin nivelin e të qenit jo funksionale?

Dhe së dyti: çfarë liderësh transformues kërkohen për të arritur ndryshimet e duhura për të mos lejuar që një organizate të bie në humnerën e jo-funksionalitetit?

Organizatat jo-funksionale është ajo e cila dështon ti shërbej qëllimit për të cilën është krijuar. Përkundrazi, ajo harxhon përpjekje dhe resurse me qëllimin e vetëm që vetes ti siguroj ekzistencën (Balthazar Cook, & Richard, 2006). Janë tri faza nëpër të cilat kalon një organizate për tu bërë jo-funksionale. Fazat dhe karakteristikat e tyre janë:

FAZAI

1. Organizatës i mungon drejtimi i qartë se kah do të shkoj.
2. Organizatës i mungon vizioni, objektivat dhe rezultatet.
3. Performanca e pritur është e pa qarte dhe e ndryshueshme.
4. Organizatës i mungojnë të dhënat inteligjente dhe analizat.
5. Ka mungesë planifikimi.
6. Ka mungesa në zgjedhjen e problemeve dhe në kreativitet.
7. Ka dështime në vendimmarrje të rëndësishme

FAZA II

1. Ka shkëputje të komunikimit në mes të administratës dhe operatives.
2. Ka dështime në fokusimin në misionin primar të organizatës.
3. Ka moral të ulët të punonjësve.
4. Organizata vepron vetëm në baza reaktive.
5. Ka dorëheqje të shumta të punonjësve të ri pas përzgjedhjes së tyre.

FAZA III

1. Menaxhimi sipas krizave bëhet normë.
2. Organizata është e mbyllur në status-quo.
3. Resurset janë të kufizuara.
4. Zyrtarët janë të de-motivuar.
5. Veshja e lidershit me pushtet të fuqishëm personal më të cilin mbron veten nga konflikti i interesit.
6. Punonjësit kanë ndjenjën e të qenit të braktisur dhe të mbetur të pa angazhuar.¹

Nuk është e nevojshme që të gjitha këto karakteristika të ekzistojnë për secilën fazë. Sidoqoftë, kurdo që shfaqen këto aspekte të jo-funksionalizimit të një organizate ka mungesë të lidershit, humbje të drejtimit të organizatës dhe demoralizim dhe mos-angazhim të punonjësve. Në aspektin operativ, punonjësit heqin dorë dhe bëjnë vetëm atë që u bie në duar sa për të thënë. Të gjithë janë të brengosur për veten e tyre dhe për njësinë në të cilën shërbejnë në kuadër të organizatës. Punonjësit nuk janë më pjesë aktive e ekipës por një grup i njerëzve të cilët vetëm paraqiten në pune sa për tu ballafaquar me përditshmërinë dhe krizat, çfarëdo që tu bie. Me fjalë tjera, e përbashkëta

është se në organizatat jo-funksionale menaxhimi është gjithmonë menaxhim i krizave dhe aty gjithnjë ka kriza.

Kur ballafaqohemi me situata kur organizata është jo-funksionale është jetësore qasja dhe njerëzit të cilët ngarkohen për të bërë zgjedhje transformuese për të nxjerr një organizate nga të qenit jo-funksionale në gjendje funksionale. Qasja dhe njerëzit e tillë nuk lindin si të tillë, ata zihen, përgatiten dhe bëhen gati nga burimi i problemit, ata kanë memorien institucionale.

Një ndër këto qasje është modeli i ndryshimeve transformuese i cili kërkon njerëz apo lidership të veçante i cili quhet lidership transformues. Sipas James MacGregor Burns (1978) lidershipi transformues është kur liderët dhe pasuesit e tyre ndihmojnë njeri tjetrin që të ngritën në një nivel më të lartë të integritetit, moralit dhe motivimit. Këta lider fillojnë me organizimin e gjetur-aktual të cilin duhet ta rishikojnë dhe rimodelojnë për të arritur nivele më të larta të performancës. Pra, transformimi i një organizate kërkon ndryshime organizative që përfshinë rrugë të reja për të menduarit strategjik, strukturor, njerëzor dhe të rezultateve konkrete në punë.

¹W..F.Walsh&G.F.VITO "Police leadership and administration" p, 113

Karakteristikat kryesore të liderëve transformues janë;

1. **Ata janë të identifikueshëm si agjent ndryshimi.** Imazhi i tyre profesional dhe personal është që ata e bëjnë dallimin nëse transformojnë organizatën.
2. **Ata janë individ të guximshëm.** Guximi nuk është budallallëk. Ata janë njerëz që pranojnë riskun, individ të cilët guxojnë të marrin qëndrim, guxojnë të thonë po dhe jo.
3. **Ata besojnë në njerëz.** Ata nuk janë diktator. Ata janë të fuqishëm por edhe të ndjeshëm për të tjerët dhe përfundimisht ata punojnë për ti fuqizuar të tjerët e jo vetën e tyre.
4. **Ata udhëhiqen nga Vlerat.** Ata janë në gjendje të artikulojnë një varg të vlerave bazike dhe të jetojnë sipas tyre, sjellja e tyre është në harmoni me vlerat që mban pozita e tyre.
5. **Ata janë mësues gjatë tërë jetës.** Ata janë në gjendje të pranojnë gabimet e tyre, të flasin për gabimet e tyre dhe ti shpjegojnë të tjerëve se çka kanë mësuar nga ato gabime.
6. **Ata kanë apetit të përhershëm për të zhvilluar vetën** dhe mësuar gjëra të reja.
7. **Ata përmirësojnë sjelljen e tyre** duke reflektuar mbi çdo njohuri dhe informacion të ri.
8. **Ata kanë dhunti për tu ballafaquar me situata** komplekse, paqartësi dhe pasiguri.
9. **Ata janë të adoptueshëm me korniza të problemeve komplekse të botes e cila po ndryshon.** Këta individ janë të përgatitur që të ballafaqohen me pjesën kulturore dhe politike të organizatës, si dhe me aspektet strukturale dhe humane. Ata kanë ide dhe janë në hap me kohën.
10. **Ata janë vizionar.** Ata janë në gjendje të ëndërrojnë dhe të përkthejnë ato ëndrra në imazhe dhe tu a japin ato imazhe njerëzve të tjerë që ata ti ndajnë ato në mes vete.²

Transformimi i suksesshëm i një organizate jo-funksionale varet tek aftësia e liderëve për të bërë të tjerët jo vetëm për të parë dhe kuptuar vizionin e organizatës por edhe për ta zbatuar atë. Ata kërkojnë që të mobilizojnë njerëz brenda dhe jashtë organizatë që ta pranojnë ndryshimin dhe të punojnë drejt arritjes së atyre ndryshimeve. Së fundi, ata i institucionalizojnë këto ndryshime përmes proceseve të planifikuara në mënyrë që ato ti rezistojnë kohëve.

Dallimi esencial është se liderët transformues jo vetëm që bëjnë ndryshime madhore, ata gjithashtu ngjallin ndryshime fundamentale në sistemin e politikave dhe kulturës organizative. Këta ekzekutues të politikave të organizatës, në vend që të mbajnë status-quo'n e organizatës, ata kërkojnë që ta ndryshojnë atë dhe ta drejtojnë organizatën e tyre në zhvillimin e sa më shumë rrugëve efektive për tu ballafaquar me sfidat që kanë sot dhe ato që do të kenë të nesërmen. Ata jetojnë me vendimmarrje efektive ose largohen, ata dine dhe guxojnë të thonë po dhe jo në vendin e duhur dhe momentin e duhur, ata njohin vetën dhe të tjerët prandaj janë fitimtar në çdo betejë.

Nga : **Arben VRAJOLLI**

Divizioni për bashkëpunim dhe informim
(Gjenerata e parë e punonjësve të IPK-së)

² W..F.Walsh&G.F.VITO "Police leadership and administration" p, 113

Rëndësia e integritetit të zyrtarët e zbatimit të ligjit

IPK realizoi në AKSP ligjëratën me temën “ Roli dhe rëndësia e integritetit te zyrtarët e agjencive të sigurisë”



Inspektorati Policor i Kosovës (IPK) përmes Divizionit për bashkëpunim dhe informim në bashkëpunim me ICITAP-in amerikan ka realizuar ligjëratë të autorizuar me studentët e Fakultetit të Sigurisë Publike në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike në Vushtrri.

Tema e trajtuar gjatë këtij aktiviteti/ligjërate që u realizua me përkrahjen e stafit akademik të Fakultetit të Sigurisë në AKSP në Vushtrri ishte “ Roli dhe rëndësia e integritetit te zyrtarët e agjencive të sigurisë”.

Gjatë diskutimit të hapur me studentët u diskutua për integritetin policor, sfidat që përcjellin organizatat drejt fuqizimit të integritetit, kodin e heshtjes, ndërlidhja e integritetit policor me besueshmërinë e qytetarëve në polici etj.

Përveç kësaj, pjesëmarrësit diskutuan së bashku për sfidat më të mëdha dhe prioritetet kryesore për fuqizimin e integritetit të agjencive të sigurisë në përgjithësi e integritetit policor në veçanti.



IPK publikoi raportin e inspektimit për “Administrimin e patentë shoferëve të konfiskuar” dhe “Administrimin e parave të imëta në Policinë e Kosovës”

Inspektorati Policor i Kosovës, respektivisht Departamenti i Inspektimeve ka publikuar Raportet e inspektimeve të rregullta në fushën “Administrimi i patentë shoferëve të konfiskuar” dhe “Administrimi i parave të imëta në Policinë e Kosovës”.

Bazuar në Planin Vjetor të Inspektimeve të Rregullta (2022) është iniciuar inspektim për të vlerësuar performancën policore në administrimin e patentë shoferëve të konfiskuar në trafikun rrugor. Inspektimi është përqendruar në tetë (8) stacione policore të kategorisë A në kuadër të Divizionit të Sigurisë Publike të Departamentit për Operacione. Inicimi i inspektimit është ndikuar nga nevoja që të vlerësohet respektimi i rregullave të trafikut në marrjen (konfiskimin) e patentë shoferëve dhe aplikimit të masave mbrojtëse dhe pikëve negative.

Gjetjet e këtij inspektimi janë me interes për zyrtarët policor në nivel lokal, si dhe nivelin mbikëqyrës dhe vendimmarrës në stacione policore.

IPK në kuadër të Raportit të inspektimit ka dhënë tre (3) rekomandime për Policinë e Kosovës që kanë të bëjnë me eliminimin e paqartësive rreth marrjes apo konfiskimit të patentë shoferëve me rastin e rishikimit të legjislacionit sekondar nga fusha e trafikut, shtimin e kontrollit mbi evidencat e plota të kundërvajtjeve, ndalimin e praktikave aktuale të konfiskimit të patentë shoferëve me rastin e shqiptimit të gjobave që lidhen me zbatimin e

Ligjit për parandalimin dhe luftimin e pandemisë Covid – 19, etj.

Lidhur me rezultatin e inspektimit duke përfshirë edhe tre rekomandimet e dhëna, të gjithë të interesuarit mund të kenë qasje në Raportin e plotë të inspektimit, i cili është i publikuar në faqen zyrtare të IPK-së (shih linkun si në vijim):

<https://ipk.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/04/Raporti-i-inspektimit-02-2022.pdf>

Inspektimi tjetër është realizuar për të vlerësuar performancën policore në administrimin e parave të imëta. Inspektimi është përqendruar në Drejtorinë për Buxhet dhe Financa në kuadër të Departamentit për Shërbime Mbështetëse. Inicimi i inspektimit është ndikuar nga nevoja që Policia të sigurohet se fondet publike shpenzohen në mënyrë të drejtë, racionale dhe ekonomike, për të mbuluar kërkesat e ligjshme të saj.



Inspektimi ka ofruar një mundësi për të vlerësuar edhe llogaridhënien dhe profesionalizmin e strukturës përkatëse policore në menaxhimin e fondeve publike.

Fokus i inspektimit ka qenë vlerësimi i respektimit të rregullave dhe procedurave të shpenzimit të parave të imëta.

Gjetjet e këtij inspektimi janë me interes për zyrtarët financiar në nivel qendror, mbajtësit e parave të imëta në nivel rajonal, si dhe nivelin mbikëqyrës dhe vendimmarrës.

IPK në kuadër të Raportit të inspektimit ka dhënë katër (4) rekomandime për Policinë e Kosovës që kanë të bëjnë me realizimin e pagesave vetëm për shpenzimet e paparashikueshme, shtimin e kontrollit menaxherial në eliminimin e faturave të

shumëfishta nga operatorë të njëjtë ekonomik, eliminimin e pagesave për faturat e reprezentacionit, shqyrtimin e mundësive për kontraktimin e artikujve të reprezentacionit, shtimin e kontrollit që pagesat të kryhen pasi të jenë ndjekur hapat procedural nga ngritja e kërkesave deri tek pranimi i parave të imëta, etj.

Lidhur me rezultatin e inspektimit duke përfshirë edhe katër (4) rekomandimet e dhëna, të gjithë të interesuarit mund të kenë qasje në Raportin e plotë të inspektimit, i cili është i publikuar në faqen zyrtare të IPK-së (shih linkun si në vijim):

<https://ipk.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/03/Raporti-i-Inspektimit-nr-01-2022.pdf>



IPK pjesë e konferencës profesionale të Shoqatës Kombëtare të Hetimeve të Brendshme (NIAIA) në Clearwater - Florida në SHBA

Kryeshefi i IPK-së Kushtrim Hodaj me bashkëpunëtorë dhe zyrtarë të ICITAP-it amerikan në Kosovë morën pjesë në konferencën profesionale të Shoqatës Kombëtare të Hetimeve të Brendshme (NIAIA) në Clearwater /Florida të SHBA-ve.

Delegacioni i IPK-së u mirëprit nga Kryetari i bordit Kapiten Chris Ray dhe zyrtarë tjerë të delegacioneve pjesëmarrëse, me të cilët po diskutohet për sfidat e mbikëqyrjes policore dhe rëndësinë e shkëmbimit të përvojave nga agjencitë homologe.

Konferenca u zhvillua nga data 17 deri 23 Shtator 2022, ku ndër tjera u diskutua për rëndësinë e integritetit të zyrtarëve policorë, metodat e hetimit dhe luftimit të rasteve të keqpërdorimit të detyrës, përdorimit të forcës, përdorimi i rrjeteve sociale, si dhe trendet në hetimet e brendshme dhe mbikëqyrjen e organeve të zbatimit të ligjit.

NIAIA është organizatë në kuadër të së cilës bëjnë pjesë mekanizmat mbikëqyrëse të policive në SHBA. Kosova përmes IPK-së nga viti i kaluar është anëtare e barabartë e kësaj organizate si shtet i parë Evropian krahas

Agjencive të zbatimit të ligjit në SHBA.

IPK vazhdon të përkrahet fuqishëm nga Departamenti i Shtetit dhe Ambasada Amerikane, ku përmes INL dhe ICITAP-it po kontribuojnë në ngritjen e kapaciteteve profesionale të IPK-së, duke përfshirë edhe realizimin e pjesëmarrjes së rregullt në punimet e konferencës. Delegacioni i IPK-së vizitoi Departamentin e Policisë në Clearwater/Florida të SHBA-ve.

Delegacioni i IPK-se dhe zyrtarët e ICITAP-it amerikan në Kosovë gjatë qëndrimit atje zhvilluan një vizitë zyrtare në Departamentin e Policisë në Clearwater/Florida të SHBA-ve.

Delegacioni i IPK-së u mirëprit nga zyrtarët e lartë të policisë z.Todd Turpack dhe z.Shante Dean nga të cilët u njoftuan me procedurat e punës me theks të veçantë për praktikat e hetimeve në njësitet për mbikëqyrjen policore dhe hetimet e brendshme.

Delegacioni i IPK-së u njoftua nga afër me ambientet e punës dhe vizitoi qendrën operative, pajisjet e veçanta të hetimit dhe qendrat e ndalimit.





13 zyrtarë të IPK-së përfunduan trajnimin për Policimin e Udhëhequr nga Inteligenca



Ky trajnim u mbajt në Prishtinë, u organizua dhe u mbështet nga Bashkimi Evropian nën udhëheqjen e NI-CO (Northern Ireland Cooperation Overseas), në kuadër të projektit 'Mbështetje e Reformës së Policisë së Kosovës'. Qëllimi i trajnimit ishte fuqizimi i kapaciteteve profesionale të zyrtarëve të IPK-së në fushën e Policimit të Udhëhequr nga Inteligenca duke përfshirë këtu edhe njohuri shtesë për teknikat analitike, vlerësimin taktik dhe strategjik, parandalimin e kriminalitetit etj.

Bashkëpunimi IPK - Agjenci për parandalimin e korrupsionit



Fotoja në vijim paraqet takimin e Drejtorit të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, Yll Buleshkaj, dhe Kryeshefit të IPK-së, Kushtrim Hodaj. Në takim u diskutuan çështje të interesit të ndërsjellët siç janë transparenca dhe integriteti i zyrtarëve publik, evitimi i konfliktit të interesit dhe mbrojtja e sinjalizuesve. Edhe pse Agjencia dhe Inspektorati kanë një bashkëpunim shumë të mirë, në takim u bisedua edhe për thellimin e këtij bashkëpunimi.

IPK dhe SHKK nënshkruajnë marrëveshje bashkëpunimi



Foto lajmi në vijim paraqet nënshkrimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet IPK-së dhe SHKK-së të nënshkruar nga Kryeshefi Ekzekutiv i IPK-së dhe z. Sami GASHI, Zëvendësues i Drejtorit të Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës, Kjo marrëveshje u nënshkrua me qëllim të avancimit dhe thellimit të bashkëpunimit në mes të dy institucioneve, për të mbështetur njëra tjetrën në përmbushjen e mandatit të tyre kushtetues dhe ligjor.

Marrëveshja përveç tjerash përfshin bashkëpunimin për mbështetje në aspektin e sigurisë gjatë transportimit të të burgosurve, shkëmbimin reciprok të informatave bazuar në autorizimet ligjore të dy institucioneve, mbështetjen reciproke në çështje të trajnimeve në fushat me interes për të dy palët etj.



INSPEKTORATI POLICOR I KOSOVËS
POLICIJSKI INSPEKTORAT KOSOVA
POLICE INSPECTORATE OF KOSOVO



**NËSE MENDONI SE U JANË SHKELUR TË DREJTAT TUAJA
NGA ZYRTARËT POLICORË, RAPORTONI NË *LINJËN E KALTËR*:
AKO MISLITE DA SU VAQ A PRAVA PREKRQENA OD STRANE POLICAJACA
POZOVITE NA *PLAVU LINIJU*:
IF YOU THINK YOUR RIGHTS WERE VIOLATED BY POLICE OFFICIALS,
REPORT IN *BLUE LINE*:**

**RAPORTONI PA PAGESË
IZVESTI BESPLATNO U
FREE OF CHARGE**



080003333

**Së bashku për një polici profesionale
Zajedno za profesionalnu policiju
Together for professional police**

IPK SIGURON KONFIDENCIALITET TË PLOTË NË TRAJTIMIN E INFORMACIONEVE
PIK OSIGURAVA POTPUNU TAJNOST U TRETIRANJU INFORMACIJAMA
PIK OFFERS FULL CONFIDENTIALITY IN TREATING THE INFORMATION